



PARIS: DREJTORI I AAC, KRISLEN KERI MERR PJESË NË PUNIMET E KONFERENCËS SË ECAC Në datat 6-7 Maj zhvillua Takimi i Drejtorëve të Përgjithshëm të Aviacionit Civil të 152 të vendeve anëtare të ECAC... **faqe 2**



TIRANË: ZHVILLOHET KURSI "SAFETY REGULATION OF AERODROMES" Gjatë muajit Maj në Autoritetin e Aviacionit Civil në kuadër të rritjeve të kapaciteteve teknike të stafit... **faqe 8**

QERSHOR 2019 - Botimi XIII

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



KOMPENSIME

RRITJE E NUMRIT TË KOMPENSIMEVE, SHIFRA SHKON NË 2397

faqe 6

NUMRI I PASAGJERËVE PRILL 2019

Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", shifrat tregojnë një numër prej 239,465 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Prill për / nga TIA.

faqe 4-5

SHPREHJE INTERESI

MUNDËSI PËR T'U BËRË PJESË E INDUSTRIËS SË AVIACIONIT

Autoriteti i Aviacionit Civil, i bën thirrje gjithë klinikave spitalore që janë pjesë e sistemit shëndetësor shqiptar, që brenda datës 31 Korrik 2019 të aplikojnë për tu certifikuar si Qendër Aeromjekësore (AeMC).

faqe 8



MIRATOHEN RREGULLAT E REJA PËR FLUTURIMIN E DELTAPLANEVE DHE PARAGLAJDEVE

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Belinda Balluku, me Urdhërin Nr. 195, datë 03.05.2019 ka miratuar rregullat e reja për të gjitha fluturimet me deltaplan ose me paraglajd, të cilat do të shërbejnë për organizmin më të mirë të këtij aktiviteti...

faqe 3

PARIS: DREJTORI I AAC, KRISLEN KERI MERR P JESË NË PUNIMET E KONFERENCËS SË ECAC

Në datat 6-7 Maj në Paris, Francë u zhvillua Takimi i Drejtorëve të Përgjithshëm të Aviacionit Civil të 152 të vendeve anëtare të ECAC. Në këtë takim u diskutuan zhvillimet e fundit lidhur me rekomandimet e auditimit të kryer në Zyrën e ICAO EUR/NAT në vitin 2018, dhe veprimet e ndërmarra nga ECAC, propozimi për krijimin e një entiteti ligjor të ECAC, zgjedhjet e Këshillit të ICAO. Gjithashtu gjatë këtij takimi u zgjodhën dy anëtarë të rinj të Komitetit Koordinues të ECAC si dhe zv. President, emërimi i Focal-Point për çështjet ekonomike në të cilën z. Keri u emërua si Deputy Focal Point për grupin ECAC Network of Chief Economists. Gjatë këtij takimi Drejtorët e Përgjithshëm u informuan për rezultatet kryesore të Këshillit të ICAO të Sesionit të 216 si dhe vazhduan me diskutimet për përgatitjet e Asamblesë së Ardhsme të ICAOs. Gjithashtu gjatë këtij takimi Drejtori Ekzekutiv i EASA si dhe Drejtori i Përgjithshëm i EUROCONTROL informuan Drejtorët e Përgjithshëm mbi aktivitetet e fundit. Mbledhja



Në foto:
Drejtori i AAC, z. Krislen Keri gjatë "Takimit të ECAC DGCA"

u ndal te çështjet më të rëndësishme për Parrezikshmërinë dhe Çështjet e ATM-së.



Në foto:
gjatë Takimit të ECAC DGCA, me drejtorët e vendeve anëtare

AAC: MIRATOHEN RREGULLAT E REJA PËR FLUTURIMIN E DELTAPLANEVE DHE PARAGLAJDEVE. JA KRITERET E REJA PËR TË FLUTURUAR ME KËTO MJETE

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, znj. Belinda Balluku, me Urdhërin Nr. 195, datë 03.05.2019, "Për miratimin e Rregullores mbi kushtet dhe mënyrat e përdorimit të Deltaplaneve dhe Paraglajdeve" ka miratuar rregullat e reja për të gjitha fluturimet me deltaplan ose me paraglajd, të cilat do të shërbejnë për organizmin më të mirë të këtij aktiviteti, ku, saktësohen më mirë kushtet si dhe shtohen terma e përkufizime të reja si më poshtë:

- Për këtë, sanksionohet që krahas njoftimeve e miratimeve në AAC, koordinimit me OSHLA, në të shumtën e rasteve, do të njoftohen edhe organet vendore dhe pronari i tokës që do të përdoret si vend ulje apo ngritje.
- Rregullat për përcaktimin e vendeve për ngritjen dhe uljen e deltaplanëve dhe paraglajdëve, regjistrimi i tyre, rregullat për përdorimin e këtyre vendeve si dhe të zonave të lejuara, të parashikuara në të detajohen duke i ardhur më në ndihmë përdoruesve dhe duke mos lënë vend për paqartësi.
- Në këtë urdhër, janë përfshirë gjithashtu kushtet për prodhimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e deltaplanëve dhe paraglajdëve, të cilat nuk parashikohen në urdhrin e shfuqizuar.
- Nenet për trajnimin, provimet, licencat dhe kategorizimet për pilotët e tyre si dhe kushtet që duhet të plotësohen nga personat juridikë lidhur me miratimin e organizatave trajnuese për kryerjen e trajnimit për pilotë që pajisen me licencë janë përmirësuar.

Autoriteti i Aviacionit Civil, i bën apel gjithë

Fletorja Zyrtare	Viti 2019 – Numri 69
13.1.11 Në çdo objekt nëntokësor ku janë montuar makineri si stacione pompimi, sallë kompresorësh, nënstacione elektrike, ofiçina mekanike etj. pavarësisht ndërcimit me llamba nga rrjeti elektrik, duhet të jetë siguruar edhe ndërcimi me llamba individuale. 13.1.12 Ndërcimi individual realizohet me pajisjen e punonjëseve që hyjnë e punojnë nëntokë me llamba individuale ndërcimi. 13.1.13 Ndalohej hyrja e punonjëseve në nëntokë, lëvizja e tyre në punimet nëntokësore dhe kryerja e punëve pa pasur llambë individuale në gjendje të mirë pune. 13.1.14 Punonjësit e nëntokës për ndërcim individual lejohet të përdorin vetëm llamba me akumulator (bateri). 13.1.15 Në çdo objekt të veprimtarisë për zhvillim të punimeve nëntokësore numri i llambave për ndërcim individual duhet të jetë 10% më shumë se sa numri i përgjithshëm i punonjëseve të nëntokës. 13.1.16 Çdo llambë e ndërcimit individual duhet të jetë e matrikulluar dhe adresuar punonjësit. 13.1.17 Llambat individuale që u jepen për përdorim punonjëseve të nëntokës duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, që të sigurojnë ndërcim dhe të japin dritë të pandërprerë për një kohë jo më pak se 10 orë. 13.1.18 Të gjithë punonjësit kur dalin nga nëntoka dorëzojnë llambën në dhomën e caktuar të kanikimit të personi përgjegjës. Personi përgjegjës për dhënie dhe marrjen në dorëzim të llambave kur konstaton rast mosdorëzimi nga punonjësi të veçantë, njofton menjëherë personelin mbikëqyrës të punimeve. Ky veprim dokumentohet në libër të veçantë. 13.1.19 Ambientet ku mbahen llambat (llambisteritë) ku jepen, merren, kanikohen, mirëmbahen, riparohen, pastrohen llambat, duhet të jenë të organizuara me persona përgjegjës, si dhe të jenë të ndërcuara e të	13.1.22 Në llambisteri punonjësit mund të marrin dhe dorëzojnë dhe maskat vetëshpëtuese individuale. 13.1.23 Me llamba ndërcimi individuale pajisen dhe punonjësit e veprimtarisë sipërfaqësore kur punojnë natën dhe në kohë të errët pavarësisht ndërcimit nga rrjeti elektrik. URDHËR Nr. 195, datë 3.5.2019 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI KUSHTET DHE MËNYRAT E PËRDORIMIT TË DELTAPLANEVE DHE PARAGLAJDEVE Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të shkronjës "c", të nenit 7, të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, URDHËROJ: 1. Miratimin e rregullores "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të deltaplanëve dhe të paraglajdëve", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij. 2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri. 3. Urdhri i ministrit nr. 49, datë 30.4.2012 "Mbi kushtet dhe metodat e përdorimit të deltaplanëve dhe parashutave", shfuqizohet. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË Belinda Balluku RREGULLORE MBI KUSHTET DHE MËNYRAT E PËRDORIMIT TË DELTAPLANEVE DHE

Në foto:
ekstrakt nga Urdhëri i Ministrit Nr. 195 datë 03.05.2019 botuar në Fletoren Zyrtare të R.SH.


personave që operojnë në këtë fushë që të kontaktojnë me autoritetin për çdo paqartësi në vijim.



Në foto:
paraglajd, gjatë një aktiviteti të organizuar në Shqipëri

TË DHËNAT PËR NUMRIN E PASAGJERËVE GJATË MUAJIT PRILL 13% MË SHUMË SE PRILL 2018

■ **PRILL 2019:** Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, shifrat tregojnë një numër prej 239,465 pasagjerësh të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Prill për/ nga TIA. Grafiku i mëposhtëm pasqyron fluksin për muajin Prill 2019 të zotërimit të tregut të transportit ajror nga secila kompani, në përqindje.




Grafiku 1:
Grafiku 1: Lëvizja e pasagjerëve që kanë udhëtuar për/ nga TIA gjatë muajit Prill 2019, sipas kompanive ajrore.

■ **PËRQINDJET:** Bazuar në të dhënat zyrtare, kompania ajrore “Blue Panorama” mbetet mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Prill 2019, me një numër prej 49,130 pasagjerë ose 21% të totalit. Ndjekur nga Ernest S.p.A me 17% ndaj totalit dhe 41,016 pasagjerë, duke vijuar me Albawings e cila zotëron tregun me 10% dhe 23,933 pasagjerë. Ky muaj ka shënuar hyrjen në treg me fluturime të rregullta të kompanisë shqiptare “Air Albania”. Gjithashtu prurje e re për tregun tone është kompania “Edelweiss Air”, e cila kryen fluturime për/ nga Zyrihu dy herë në javë. 2384 pasagjerë kanë zgjedhur të fluturojnë me këtë kompani përgjatë muajit Prill.


NUMRI I PASAGJERËVE Italia zotëron përqindjen më të madhe në tregun e transportit ajror për muajin Prill 2019, duke zënë 56% të totalit dhe një numër prej 132,769 pasagjerë, ndjekur nga Turqia me 7%, Austria me 7% si dhe Hungaria 6%. Nëse do të bënim krahasimin e tre viteve të fundit, trafiku ajror dhe fluksi i pasagjerëve këtë vit, gjatë Prillit të 2019 ka një rritje prej 13% krahasuar me vitin e kaluar 2018. Tabela e mëposhtme jep një informacion të plotë krahasimor për muajin Prill të tre viteve të fundit të numrit të pasagjerëve sipas shoqërive ajrore.

Tabela 1:
Numri i pasagjerëve për muajin Prill gjatë viteve 2017, 2018, 2019



Përsa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Prill 2017-2018-2019, vëmë re se numri i pasagjerëve që kanë fluturuar me Charter ka shënuar rritje prej 306 %, pasuar nga kompania Wizz Air, shifrat e të cilës tregojnë për një rritje me 180% e krahasuar me Prillin e 2018. Rritje të dukshme krahasuar me një vit më parë ka pasur dhe kompania Lufthansa me 107%. Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve në muajin Prill 2019 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018 dhe 2017


Grafiku 2:
Numri i pasagjerëve për muajin Prill 2017, Prill 2018, Prill 2019 sipas operatorëve ajrorë.



TË DREJTAT E PASAGJERIT

KOMPENSIMET: RRRITET SHIFRA 200 KOMPENSIME NË MAJ. TOTALI SHKON NË 2397.


Sipas të dhënave që na vijnë nga SDP që Autoriteti i Aviacionit ka krijuar për të monitoruar zbatimin e ligjit për kompensimet e pasagjerëve në rast të vonesave dhe anulimit të fluturimeve, rezultojnë se numri total i kompensimeve ka shkuar në 2397. Krahësuar me muajin e kaluar kemi një rritje me rreth 200 kompensime më shumë krahasuar me muajin e kaluar. Duke u bazuar edhe në tabelën e mëposhtme rezultojnë se kompania me numrin më të lartë të kompensimeve rezultojnë Blue Panorama, e ndjekur nga kompania Ernest dhe British Airways. Një numër i konsiderueshëm kompensimesh janë në proces. Autoriteti i Aviacionit Civil, ripërsërit apelin ndaj gjithë personave që kanë plotësuar një formular ankimi që të kontaktojnë kompanitë ajrore për të ndjekur me tej procesin. Ndërkohë duke qenë se po afrohet edhe sezoni turistik që regjistron edhe pikun e fluturimeve dhe problematikave në vonesa dhe anulime, i bën thirrje pasagjerëve që për çdo paqartësi ose problem me kompanitë ajrore të kontaktojnë sektorin për të drejtat e Pasagjerëve që AAC ka hapur prej 2 vitesh në Aeroport.



AAC i bën thirrje të gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët e ankimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:




www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit



RAPORTI PERFORMANCËS:

VONESAT E KOMPANIVE AJRORE PËR MUAJIN MAJ

Nga informacioni i ardhur nga Sektori për të Drejtat e Pasagjerëve që AAC ka në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza, kompania me më shumë vonesa për muajin Maj është kompania WIZZAIR me 3 të tilla mbi 2 orë, më pas vjen kompania ADRIA AIRWAYS me 3 vonesa, për tu pasuar nga kompania ERNEST me 1 vonesë dhe 6 anulime, 5 prej të cilave si pasojë e grevës 1 ditore në Itali.



TIRANË: ZHVILLOHET KURSI "SAFETY REGULATION OF AERODROMES"

Gjatë muajit Maj në Autoritetin e Aviacionit Civil në kuadër të rritjeve të kapaciteteve teknike të stafit u zhvillua kursi "Safety Regulation of Aerodromes". Ky kurs trajtoj një pamje të përgjithshme mbi kontekstin e rregulloreve europiane të aerodromeve, duke u ndalur te procesi i certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme. Në këtë kurs morën pjesë inspektorë teknikë të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Aeroporteve dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Sigurisë në Operim dhe Vlefshmërisë Ajror dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion si dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Shërbimit të Lundrimit Ajror, rreth 10 specialistë të AAC. Ky kurs shërben për rritjen e kapaciteteve për të përballuar në të ardhmen fillimin e operacioneve ajrore të Aeroportit të Kukësit dhe më tej ndërtimin e Aeroportit të Vlorës. Kursi vjen në bashkëpunim të ngushtë me organizatën e njohur të trajnimeve në Europë JAA TO, ku ekspertët ndër më të mirët e kësaj fushe vijnë në Shqipëri dhe ofrojnë trajnime të specializuara.



Në Foto:

Inspektorët teknikë të drejtorive të AAC gjatë trajnimit të zhvilluar pranë zyrave të AAC nëpërmjet organizatës së trajnimeve JAA TO.

MUNDËSI PËR T'U BËRË PJESË E INDUSTRIËS SË AVIACIONIT CIVIL

Autoriteti i Aviacionit Civil, i bën thirrje gjithë klinikave spitalore që janë pjesë e sistemit shëndetësor shqiptar, që brenda datës **31 Korrik 2019** të aplikojnë për tu certifikuar si Qendër Aeromjekësore (AeMC). Qendrat Aeromjekësore

(AeMC) dhe Ekzaminuesit Aeromjekësorë individualë (AME-të), kanë qëllim kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të Ekuipazheve Ajrore (Pilotë dhe Ekuipazh i Kabinës), duke përfshirë ato për përshtatshmërinë psikofizike të Kontrollorëve të Trafikut Ajror.

Më poshtë do të gjeni adresën elektronike, gjithashtu, njoftimin e plotë mund ta gjeni në faqen zyrtare të AAC-së **www.aac.gov.al** me të gjithë kërkesat ligjore dhe dokumentet e nevojshme që duhet të plotësohen për të qenë një Qendër Aeromjekësore e certifikuar. Për depozitimin e aplikimit, si dhe për çdo informacion, mund të na kontaktoni në **info@aca.gov.al** ose në numrat e telefonit: **+355 4 22 51 220 / 22 23 969**



në Botë

Aviacioni



AIRBUS FESTON 50 VJETORIT E THEMELIMIT

Kompania e njohur europiane e prodhimit të avionëve AIRBUS ka festuar 50 vjetorin e themelimit të saj. Me një fushatë globale të filluar nga qyteti i Toulouse në Francë baza kryesore, kompania ka treguar me foto progresin dhe momentet kyç të saj në këto 50 vite. Gjithçka filloj 50 vite më parë, kur ministri Francez i Transportit dhe ai Gjerman i Ekonomisë firmosën marrëveshjen në 29 Maj 1969 për krijimin e avionit të parë europian me 2 motor që mori emërtimin A300. Më pas kësaj kompanie ju bashkuan edhe shtetet e tjera si Britania e Madhe dhe Spanja. Por paqëndrueshmëria e Britanisë ka vënë disa herë në vështirësi kompaninë europiane, që në boshtin kryesor e ka Berlin-Paris. Vetë CEO i Airbus, Guillaume Faury tha se historia e kësaj kompanie është e bazuar në 2 elemente të rëndësishëm, inovacion dhe progres. Sipas tij Airbus

në 50 vite ka ndikuar në integrimin më të madh të popujve europiane dhe afrimin e tyre me njëri-tjetrin. Ekspertët thonë se pika e dobët e AIRBUS është mos bashkëpunimi i plotë i qeverive europiane dhe mungesa e menaxhimit të duhur. Fluturimi i parë i Airbus A300 ishte nga Parisi në Londër. Airbus në 50 vite është kthyer në një kompani lider së bashku me Amerikanen Boeing, duke ndarë pothuajse në shifra të barabarta tregun global. Para se Airbus të krijohet në 1959, qiejt dominoheshin nga 2 kompani amerikane Boeing dhe Douflas DC-8, por futja e Airbus ndryshoj balancat botërore. Sot në qiejt botëror numërohen rreth 12 mijë avionë Airbus, ndërsa industria e aviacionit shkon në 150 miliard dollarë në vit me rreth 130 mijë të punësuar në prodhimin e avionëve.

